

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-155 WN

PRAJMER RRËSHIRE EPOKSIDE ME 2 PËRBËRËS I SHPËRNDARË NË UJË



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-155 WN është prajmer me bazë rrëshire epokside pa tretës dhe i shpërndarë në ujë.

PËRDORIMET

Sikafloor®-155 WN duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Si një prajmer dhe përmirësues i ndërkapjes mbi nënshtresat e mëposhtme të përgatitura saktë:

- Beton i ri
- Llaçe çimentoje për dysheme
- Beton i ngurtësuar
- Veshje ekzistuese dyshemeje epokside
- Shtresa niveluese

Si një prajmer për:

- Sikafloor®-81 EpoCem® dhe Sikafloor®-82 EpoCem®
- Sikafloor® -20N PurCem® dhe Sikafloor® -21N PurCem® nëse kërkohet.
- Produkte të serisë Sikafloor® -Level®

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i lehtë dhe i shpejtë
- Veçanërisht i përshtatshëm për nënshtresa shumë absorbuese
- I shpërndarë në ujë dhe pa erë
- Mund të aplikohet në zona të paventiluara
- Rezistencë shumë e mirë e ngjitjes në të gjithë shkallën e temperaturave të aplikimit
- Miqësor ndaj mjedisit

MIRATIME / STANDARDE

Llaç dyshemeje rrëshire sintetike sipas EN 13813:2002, Deklaratë Performance 02 08 01 02 006 0 000003 1053 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Epoksid i shpërndarë në ujë	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 7.5 kg
	Përbërësi B	kovë 2.5 kg
	Përbërësit A+B	njësi 10 kg gati për përzierje
Paraqitja / Ngjyra	Rrëshira - përbërësi A	pastë e trashë me ngjyrë
	Forcuesi - përbërësi B	emulsion i tejdukshëm e verdhë e lehtë
	Rrëshira e përzierë	E kuqe oksidi (~ RAL 3009)
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.	

Dendësia	Përbërësi A	~ 1.6 kg /l	(DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~ 1.1 kg /l	
	Rrëshira e përzierë	~ 1.4 kg /l	

Të gjitha vlerat e dendësisë në 23°C.

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~70 %
peshë

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~56 %
vëllim

Viskoziteti 4 900 mPa·s (+20 °C) Contraves (RM 180 Rheomat)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje >1.5 N/mm²(dështim betoni)28 ditë në +23°C/50% lagështi relative (EN 13892-8)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet 1 - 2 veshje Sikafloor®-155 WN (në varësi të porozitetit të nënshtresës)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes Përbërësit A : B = 3 : 1 për peshë

Konsumimi 0.3 - 0.5 kg/m²/veshje (2.0 - 3.3 m² / kg / veshje)
Sikafloor®-155 WN, holluar me 10% ujë (për peshë) për veshjen e parë.
Pa hollim për veshjen e dytë.
Kjo vlerë është teorike dhe nuk përlogarit asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

Trashësia e shtresës ~110 - 180 µm për veshje (trashësia e cipës së thatë)

Temperatura e mjedisit +10 °C min. / +35 °C max.

Lagështia relative e ajrit 85 % max.

Pika e vesës Kujdes kondensimin!
Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit apo çngjyrosjes mbi sipërfaqen e produktit të aplikuar.

Temperatura e nënshtresës +10 °C min. / +35 °C max.

Lagështia e përmbajtur e nënshtresës Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë. Konfirmoni gjithmonë lagështinë e përmbajtur të nënshtresës përpara aplikimit të prajmerit:
▪ <4% për shtresa rrëshire të papërshkueshme. Pa rritje të lagështisë sipas testit ASTM D 4263 (fletë polietileni).
▪ Mund të aplikohet mbi beton të freskët/ me moshë të vogël kur mbivishet me serinë Sikafloor® EpoCem® pa ujë të mbledhur mbi sipërfaqe.

Koha e punueshmërisë	Temperatura	Koha
	+10 °C	~ 180 minuta
	+20 °C	~ 90 minuta
	+30 °C	~ 90 minuta

Të gjitha vlerat e mësipërme në 75% lagështi relative ajri.
Kujdes: Koha e punueshmërisë mbaron pa ndryshim të dukshëm.

Koha e maturimit

Përpara aplikimit të Sikafloor®-81 / -82 EpoCem® mbi Sikafloor®-155 WN lini:

Temperatura e nënshtresës	Koha min. e pritjes	Koha max. e pritjes
+10 °C	12 orë	72 orë
+20 °C	6 orë	48 orë
+30 °C	4 orë	24 orë

Në temperatura të ulëta dhe/ose lagështi të lartë koha e tharjes do të rritet.

Aplikoni veshjet vijuese vetëm mbi prajmerin që nuk ngjit.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Temperatura e nënshtresës	Qarkullim këmbësorësh
+10 °C	~12 orë
+20 °C	~6 orë
+30 °C	~4 orë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa e betonit duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (min. 25 N/mm²) me rezistencë min. ndaj tërheqjes 1.5 N/mm².
- Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pislleqet, vaj, graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj.
- Nënshtresat prej betoni duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive ose shkriktor për të hequr koren e çimentos dhe për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur.
- Betoni i dobët duhet të hiqet dhe defektet mbi sipërfaqe si vrimat dhe hapësirat duhet të ekspozohen plotësisht.
- Riparimet mbi nënshtresë, mbushja e vrimave/hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes mund të kryhen duke përdorur produktet e përshtatshme nga seria e materialeve Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard®.
- I gjithë pluhuri, materiali i lirë dhe shkriktorët duhet të hiqet plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë ose vakuum.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes, përziene plotësisht përbërësin A (rrëshira), pastaj shtoni të gjithë përbërësin B (forcuesi) dhe përziene plotësisht të dy përbërësit e lëngshëm për 1 minutë derisa të arrihet një miks i njëtrajtshëm.

Kur përbërësit A & B të jenë përzierë për 1 minutë për veshjen e parë, shtoni ngadalë 10% ujë të pastër ndërsa përzierja vazhdon edhe për 2 minuta të tjera, derisa të arrihet një miks homogjen.

Për veshjen e dytë, mos hidhni ujë shtesë, por vazhdoni përzierjen për 3 minuta derisa të arrihet një miks homogjen.

Për të siguruar përzierjen e plotë të të dyja veshjeve, pas min. 3 minutash përzierjeje, hidhni materialin e përzierë brenda një ene tjetër duke kuar me kujdes muret e brendshëm, fundin e enës dhe mikserin me shpatull dhe përziene sërish për të siguruar përzierje të plotë.

Përzierja e tepruar duhet të shmanget gjithashtu për të minimizuar bllokimin e ajrit.

Veglat e përzierjes

Mikser elektrik në shpejtësi të ulët (~300-400 rpm)

APLIKIMI

Aplikoni Sikafloor®-155 WN me furçë të përshtatshme, rul ose mallë dhe punojeni përsipër me rul.

Kujdes

Fundi i kohës së punueshmërisë së produktit nuk është i dukshëm! Respektoni kufizimet e përmendura. Hidhni materialin i cili nuk është përdorur brenda kohës që është ende i punueshëm.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Cilësia e nënshtresës & Përgatitja

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".

Udhëzime aplikimi

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".

Mirëmbajtja

Ju lutemi referohuni tek "Sikafloor®- REGJIMI I PASTRIMIT".

KUFIZIME

- Në temperatura të ulëta dhe/ose lagështi të lartë, koha e tharjes do të zgjatet.
- Mbroni aplikimin nga shiu / uji ndërsa ndodh reaksioni dhe tharja.
- Hollimi i veshjes së parë me 10% ujë për peshë ndihmon përmirësimin e ngjitjes mbi nënshtresa të dendura ose me absorbueshmëri të pakët, si dhe gjithashtu edhe në reduktimin e materialit mbi nënshtresa me porozitet tepër të lartë. Veshja e dytë duhet të aplikohet e paholluar.
- Sigurohuni të monitoroni dhe kontrolloni kohën e punueshmërisë së miksit pasi fundi i kësaj kohe nuk është i dukshëm. Hidhni materialin i cili është në kufirin e kohës së punueshmërisë për kushtet ekzistuese të aplikimit!

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / j lloji wb) është 140 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja maksimale e Sikafloor®-155 WN është ≤ 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-155 WN

Mars 2019, Botimi 03.01

020811010010000002

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikafloor-155WN-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf